



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.51

Prishtinë, më 11.5.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,  
KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sërgjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Blerim Rexha dhe përfaqësues të Këshillit Shtetëror për Cilësi, KDI, mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutimi lidhur me Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, i ftuar Blerim Rexha, kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Diskutimi lidhur me Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, i ftuar Blerim Rexha;**

Nait Hasani, kryetar tha se Komisioni do të njoftohet për së afërmi me gjendjen në të cilën ndodhët aktualisht Agjencia për Akreditim e Kosovës, dhe raportin të përgatitur nga Këshilli Shtetëror për Cilësi, si dhe gjendjen aktuale që është në kolegjet private dhe Universitetet Publike në vend.

Blerim Rexha, tha se Këshilli Shtetëror për Cilësi ka prezantuar para Komisionit raportin i cili përmban statistikat dhe gjendjen e procesit të akreditimit, për periudhën prill 2015- prill 2016. Këshilli ka bërë një analizë të situatës aktuale konform udhëzimit administrativ, pa pasur tendencë që ky udhëzim të plotësohet në të gjitha pikat, pasi që Këshilli e ka parë këtë si një mundësi të ashpërsimit të kriterëve për institucionet e Arsimit të Lartë. Të gjitha zhvillimet do të ndodhin në koordinim me prioritetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Strategjinë e Re për Arsim. Në raport është cekur njëri nga kriteret që është stafi akademik, dhe në bazë të kësaj, Agjencia ka kërkuar që të gjithë bartësit e arsimit të lartë publik apo privat të plotësojnë këtë kriter të paraparë me udhëzim administrativ. Në bazë të kësaj, secili institucion duhet të ketë së paku tre doktorë shkence të fushës përkatëse, për të vazhduar procesin e akreditimit të programit të studimeve. Raporti përmban një tabelë përmbledhëse të stafit akademik, që është i angazhuar në Kosovë me orar të plotë, konform Ligjit të Punës dhe ligjeve tjera në fuqi, ndërkaq nga tabela mund të vërehet se ka ende mungesë të stafit akademik në vend, e që tash për tash është shqetësimi kryesor për Arsimin e Lartë në Kosovë.

Këshilli i Kosovës për Cilësi është i angazhuar që të rrisë cilësinë e programeve të studimit, në bashkëpunim me institucionet , Agjencia do të vazhdojë me përkushtim të bëjë punën e saj, duke u përpjekur që gradualisht të implementohet udhëzimi administrativ në tërësi.

Nait Hasani, kryetar, shtroi çështjen e riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, përkatësisht 257 aplikacionet që janë në shqyrtim gjatë këtij procesi, si dhe pyeti për mundësitë e

implementimit të udhëzimit administrativ ku kërkohet që institucionet e arsimit të lartë të kenë nga tre doktorë shkence, si kriter për t'u akredituar.

Universiteti i Gjakovës gjatë vitit të kaluar nuk pati asnjë program të akredituar, dhe probleme me akreditim pati edhe Universiteti i Prishtinës me lëndën e matematikës. Duke iu referuar raportit, janë akredituar deri më tani 192 dhe refuzimin e 62 programeve të studimit, kërkoi sqarim shtesë lidhur më këtë çështje.

Blerim Rexha, theksoi se Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka parë një diskrepancë në mes të procedurave të më hershme, ku shumë programeve të studimit u është lejuar të vazhdojnë procedurat për riakreditim edhe pa plotësuar kushtet formale. Në fund të procesit të akreditimit nga ekspertët ndërkombëtarë kemi parë që këto institucione nuk kanë staf adekuat, kompetent për t'i mbajtur ligjëratat. Dhe kështu, Këshilli ka marr një vendim konform udhëzimit administrativ, që nuk ka logjikë të vazhdohet me procesin e riakreditimit, nëse nuk ka staf kompetent njësi akademike, gjegjësisht institucioni i arsimit të lartë, qoftë ai privat ose publik. Duke iu referuar udhëzimit administrativ, së pari kemi bërë verifikimin formal në agjenci, dhe të lejohen më tutje procedurat e riakreditimit. Kështu, ne i kemi refuzuar në mbledhjen e prillit përfundimisht akreditimin për institucionet që kanë mungesë në përmbushjen e këtyre kriterëve, por që këto institucione kanë mundësi që të fillojnë me procedurat e akreditimit përsëri pasi të përmbushin kriteret e caktuara në udhëzimin administrativ.

Agjencia e Kosovës për Cilësi angazhohet që në vazhdimësi të përmirësojë cilësinë, duke filluar nga stafi akademik.

Salih Morina, tha se duke iu referuar raporteve që janë sjellë në Komisionin për Arsim, mund të vërejmë se cilësia e arsimit në vend nuk është e kënaqshme. Në bazë të të dhënave nga ky raport, vërehet që ka mungesë të stafit akademik. Në Universitetin e Prishtinës ka dualizëm në programe të studimit, deri sa kemi drejtimin e gjeografisë në Fakultetin e Shkencave Natyrore , në anën tjetër kemi edhe drejtimin e gjeografisë në Fakultetin e Edukimit. Në të njëjtën kohe, kemi dy kuadro të të diplomuarve dhe gjatë konkursit publik për mësimdhënie, thuhet se ka përparësi kandidati që ka diplomuar në drejtimin e gjeografisë në Fakultetin e Edukimit. Kërkoj nga Këshilli për Cilësi që ta shqyrtojë këtë çështje edhe në nivel me ministrin e Arsimit, pasi një dualizëm i tillë është i panevojshëm në Universitetin e Prishtinës. Dhe çështja tjetër është numri

jashtëzakonisht i madh i kolegjeve publike dhe private që janë me të njëjtat programe të studimit. Është e nevojshme që të bëhet ndërlidhja e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës, në mënyrë që studentet kosovarë të gjinden më lehtë në tregun e punës.

Shpejtim Bulliqi, tha se raporti është përgatitur jashtëzakonisht mirë dhe përmban të dhëna që janë në interes Komisionit për Arsim dhe opinionit në përgjithësi.

Bulliqi ngriti çështjen e një numri relativisht të madh të kolegjeve private të Arsimit të Lartë dhe pjesa dërmuese e tyre ka të njëjtat programe të studimit, duke i ofruar kështu tregut të punës së Kosovës studentë të kualifikuar në profile të njëjta.

Ai pyeti për mundësinë që Këshilli Shtetëror për Cilësi të bëjë një kufizim në këtë aspekt, në mënyrë që të ketë një raport të drejtë në mes të profileve dhe tregut të punës. Lidhur me mosakreditimin e programeve master, Këshilli Shtetëror i Cilësisë duhet të shqyrtojë këtë çështje dhe të hapë profile të tjera të studimeve si dhe të shqyrtojë mundësinë për bashkëpunim në mes të fakulteteve bazë të lëndëve përkatëse dhe Fakultetit të Edukimit. Është mirë që të shqyrtohen edhe problemet që po ndodhin në zbatimin praktik të udhëzimeve administrative, ku në rastin e lëndës së astronomisë, në shkollat e mesme, gjeografëve u është pamundësuar e drejta që të jenë pjesë e kësaj lënde, duke iu dhënë përparësi profilit të fizikanëve. Dhe një udhëzim administrativ i tillë nuk i kufizon vetëm profilet adekuate që të përfshihen në mësimdhënie, por bënë edhe kufizimin e nxënësve që të njihen me formën më të mirë të mundshme të njohurive dhe mësimin në lëndën përkatëse mësimore.

Bekim Haxhiu, tha se Agjencia për Cilësi e Kosovës, ka filluar të marrë rolin e tij si një institucion i një rëndësie të veçantë dhe kredibil. Ngritja e cilësisë në arsim bëhet vetëm duke i respektuar kriteret në akreditim, dhe Agjencia për Cilësi e Kosovës, ka një rol kyç në këtë proces të rëndësishëm. Sipas ligjit për Arsimin e Lartë, institucionet e arsimit të lartë, private dhe publike, gëzojnë trajtim të barabartë, si politikë e mirëfilltë shtetërore do të ishte orientimi i akreditimit të programeve, që janë në përputhje me nevojat shtetërore, në sektorin publik, por një gjë e tillë nuk mund të ndodhë në sektorin privat, për shkak të formës të ndryshme të menaxhimit të brendshëm të institucioneve private të arsimit të lartë. Gjithmonë duke i respektuar kriteret ligjore për akreditimin, shumë institucione private të arsimit të lartë kanë staf të rregullt të angazhuar dhe qëndrojnë më mirë në këtë aspekt sesa disa institucione publike të arsimit të lartë, e ndërkaq gëzojnë emërtimin kolegje.

Do të ishte e nevojshme që Agjencia për Cilësi e Kosovës të shikojë mundësitë e emërtimeve të këtyre institucioneve të arsimit të lartë në vend. Në akreditimin e nivelit master, institucionet arsimit të lartë publik qëndrojnë më mirë, ndërsa tek niveli i doktoratës është krijuar monopol i sektorit publik. Në mënyrë që trajtimin të njëjtë para ligjit, të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në vend, do të ishte mirë që t'u jepej mundësia për akreditimin të programeve të doktoratës edhe institucioneve private, në qoftë se konstatohet se ato i plotësojnë kriteret e rregulluara me ligj. Derisa bëhet nostrifikimi i diplomave të institucioneve private të arsimit të lartë, të rajonit dhe vendeve tjera, do të ishte e padrejtë që të rinjve tanë mos t'u mundësohet një gjë e tillë edhe në vendin e tyre, ku ata do të kenë mundësi të kërkojnë për dije dhe përgatitje profesionale të merituar. Gjithashtu është krijuar monopol edhe me ndarjen e gradave shkencore, vetëm në institucionet e arsimit të lartë publik në vend. Do të ishte mirë që në të ardhmen të shikohet mundësia e ofrimit të këtyre kompetencave edhe për institucionet private të arsimit të lartë, në mënyrë që të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend të trajtoheshin të barabarta para ligjit, të kenë kompetenca të njëjta dhe së bashku të angazhohemi në rritjen e cilësisë së arsimit në vend.

Mufera Shinik, ngriti çështjen e përbërjes së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, me ç'rast tha se në përbërjen e këtij Këshilli, nuk është respektuar përfshirja në kriteret e barazisë gjinore dhe etnike. Pasi në përbërjen e shtatë anëtarëve të Këshillit, ka vetëm një femër dhe asnjë pjesëtarë nga komunitetet në vend.

Shpejtim Bulliqi, pyeti se si qëndron Këshilli Shtetëror i Cilësisë në procesin e akreditimit të programeve në Universitetin që vepron në veriun e Mitrovicës. Pasi që shpesh në praktikë po ka paqartësi me diplomat nga ky Universitet dhe procedurat e nostrifikimit.

Blerim Rexha, tha se Këshilli Shtetëror i Cilësisë angazhohet që të bëjë përmbyshjen e kriterëve për rritjen e cilësisë në arsimin e lartë, duke i respektuar ligjet aktuale në fuqi. Duke iu përkujtuar që çdo vit në institucionet e arsimit të lartë përfshihen 33.000 fëmijë që përfundojnë testin e maturës shtetërore.

Rexha, tha se ofrimi i programeve të arsimit të lartë që janë në përputhje me nevojat e tregut të punës, do të fillojë të bëhet duke e vendosur numrin maksimal të studentëve që do të regjistrohen

në profile të caktuara. Gjithashtu gjatë procesit të akreditimit do të kërkohet që të bëhet analiza e nevojës së tregut të punës për profile të caktuara.

Sa i përket akreditimit të programeve në Universitetin e veriut të Mitrovicës, kjo është më shumë çështje politike sesa praktike dhe punë e Agjencisë. Shpresojmë që me dialogun e Brukselit të zgjidhet edhe korniza ligjore dhe Agjencia do të fillojë procesin e njëjtë sikur edhe me institucionet tjera.

Sa i përket përbërjes së Këshillit, kjo është caktuar nga Ministria e Arsimit dhe Këshilli do të mirëpriste edhe anëtarë të etnive tjera dhe më shumë femra në përbërje, që persona të profileve të ndryshëm të japin maksimumin e tyre në të gjitha proceset e Këshillit.

Nait Hasani, falënderoi kryetarin e Këshillit të Kosovës për Cilësi, përfaqësuesit e tjerë për prezantimin e të gjeturave të raportit, që pasqyrojnë punën njëvjeçare të këtij institucioni dhe gjendjen në institucionet e arsimit të lartë në vend. Ai tha se Komisioni do të angazhohet që bashkërisht me institucionet tjera në vend të ngritë cilësinë e arsimit në Kosovë, dhe në krijim e kushteve adekuate që të rinjtë tanë të studiojnë në profile që janë në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Kërkojmë nga Agjencia e Kosovës për Cilësi, që të jetë rigoroz ndaj kritereve të përcaktuara me ligj dhe të jetë objektive gjatë procesit të akreditimit dhe procedurave të riakreditimit të programeve të caktuara. Në mënyrë që së bashku të krijojmë mundësi të denjë që të rinjtë e vendit tonë të arsimohen, dhe të aftësohen për tregun e punës, duke krijuar kështu një të ardhme më të mirë për ta dhe vendin në përgjithësi, theksoi Hasani.

### **3. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,**

**Nait Hasani**

